



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 12.12.2023)*

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:07 dhe mbaroi në orën 12:13.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Ilir Rusi (zëvendëskryetar)*
- 3. Klodian Kurushi (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Emona Muçi (anëtare)*
- 6. Ridvan Hado (anëtar)*
- 7. Irena Plaku (anëtare)*
- 8. Alban Toro (anëtar)*
- 9. Gentiana Muçaj (anëtare)*
- 10. Markelian Koça (anëtar)*
- 11. Yllka Rupa (anëtare)*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 5. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
- 6. Brikena Ukperaj, Marçela Shehu dhe Dritan Hallunaj, ish-anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (gjyqtarë) (në sallë).*
- 7. Erjon Muharremaj, ish-anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Luan Dibra, Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 9. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 10. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimeve:

1.1 Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Brikena Ukperaj.

1.2 Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Marçela Shehu.

1.3 Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Dritan Hallunaj.

*Naureda Llagami: Përsëndetje të gjithëve!*

Po fillojmë mbledhjen, në fakt nuk është e radhës, kjo është mbledhje jashtë radhe, e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 12 dhjetor.

Kam kënaqësinë sot që këtë mbledhje ta drejtoj me kolegët e rinj që i janë bashkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, por në radhë të parë dua të falënderoj kolegët që kanë shërbyer deri tani pranë këtij Këshilli dhe që sot në fakt kthehen në sistemin gjyqësor, znj. Brikena Ukperaj, z. Dritan Hallunaj dhe znj. Marçela Shehu. Uroj në fakt që kjo përvojë që ato kanë pasur në Këshill të ketë vlejtur për ta parë gjyqësorin në fakt me një këndvështrim të ri.

Gjithashtu në fakt uroj edhe mirëseardhjen e anëtarëve të rinj të këtij Këshilli, që është znj. Emona Muçi e cila përfaqëson gjykatat e apelit, është zonja Genta Muçaj e cila përfaqëson gjykatën e shkallës së parë dhe zoti Markelian Koça, edhe ai përfaqëson gjykatën e shkallës së parë, jashtë Tiranës. Nga sot në fakt ju keni një përgjegjësi për të çuar më tej atë çfarë ne kemi filluar me kolegët tuaj dhe për të arritur në standarde edhe më të larta. Është sfidë jo vetëm që të vendosim standardet (ato që bëmë bashkë ne me kolegët), por do jetë sfidë në fakt që si do i mbajmë këto standarde; dhe të jesh në fakt anëtar i Këshillit, do të ndryshojë mënyrën tuaj jo vetëm të të punuarit por edhe të të menduarit. Nga sot nuk do jeni vetëm ju dhe mendimi juaj, por jeni në fakt zëri i gjithë sistemit.

Prandaj në emër të të gjithë kolegëve të tjerë këtu, ju uroj punë të mbarë dhe me krahë të lehta, që i bashkoheni skuadrës sonë.

Për të kaluar edhe tek rendi i ditës, sot janë tre akte që lidhen me deklarinimin e mbarimit të mandatit të tre anëtarëve.

Fillojmë me aktin e parë që është mbarimi i mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, të znj. Brikena Ukperaj.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Gentiana Muçaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord me propozimin.

Të them edhe unë dy gjëra të vogla. Fillimisht i uroj mirëseardhjen kolegëve. I uroj që të vijnë me krahë të lehta dhe me këmbë të mbarë dhe punët të gjithëve të na shkojnë mirë, se kjo punë është punë grupi, siç e tha edhe Kryetarja. Ndjej keqardhje për kolegët që na largohen nga ky rrugëtim i përbashkët që kemi bërë, nga këto sfida që ne kemi ndarë bashkërisht me njëri-tjetrin, ndonjëherë kohë e keqe por shumë herë kohë të bukura kemi kaluar bashkërisht. Më vjen keq për zonjën Ukperaj, zonjën Shehu dhe zotin Hallunaj që nuk do t'i kemi më si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, por gjithsesi në memorien time nuk shlyhen ndonjëherë çastet e mira dhe sfidat e mira që ne kemi kaluar bashkërisht. Ju falënderoj për kontributin që keni dhënë edhe do jemi gjithmonë bashkëpunues edhe jashtë pozicioneve që ne nuk i kemi më aktualisht sot. Faleminderit! Edhe unë jam dakord me keqardhje për këtë propozim që bëtë.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Brikena Ukperaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek propozimi i aktit të dytë që ka të bëjë me deklarimin e mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Marçela Shehu.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Pro.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Marçela Shehu.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek aktit i fundit që ka të bëjë me deklarinimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Hallunaj.

**Illir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Dritan Hallunaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot, duke ju ftuar të gjithë ju, bashkë edhe kolegët, edhe të ftuarit, drejt një “cocktail-i”, për t’i uruar mirëseardhjen të rinjve dhe për t’i uruar suksese në detyrë anëtarëve të mëparshëm.

Faleminderit të gjithëve!

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**